

MINISTRIA SAKSONE E SHTETIT PËR ARSIM
Kutia Postare 10 09 10 | 01079 Dresden

Për
nxënëset dhe nxënësit e moshës 12 vjeç e sipër
dhe prindërit e tyre në shkollat
publike dhe private
në Shtetin e Lirë të Saksonisë (Sachsen)

Dresden, gusht 2021

Mundësi për t'u vaksinuar vullnetarisht ndaj koronavirusit SARS-CoV-2

Të dashur nxënës dhe nxënëse!
Të dashur prindër, të nderuar zonja dhe zotërinj!

Ora e mësimit e ka vendin në shkollë dhe jo në dhomën e fëmijve. Të mësuarit dhe të qenit së bashku në klasë është përparësia jonë kryesore. Sepse për fëmijët dhe të rinjtë bëhet fjalë për perspektivat e tyre të së ardhmes dhe rritjen e tyre të shëndetshme. Për të siguruar këtë, edhe në vitin shkollor 2021/2022 do të jenë të nevojshme masat mbrojtëse.

Nuk është e projektuar që të ketë një mbyllje mbarëkombëtare të shkollave - edhe nëse numri i infeksioneve rritet. Sidoqoftë, nëse kapaciteti i shtretërve në spitale arrin kufirin e mbingarkesës, mësimi në prezencë duhet të kufizohet. Kjo do të thotë atëherë, që mësimi në shkollën tuaj do të zhvillohet përsëri me turne.

Nga studimet shkencore e dimë, se fëmijët dhe adoleshentët (të rinjtë) nuk janë nxitësit e pandemisë dhe janë më pak të rrezikuar nga virusi sesa të rriturit. Megjithatë, shkollat nuk janë të paprekura nga infeksioni. Prandaj është e rëndësishme që të vazhdojmë të tregojmë shumë kujdes.

Ne e kemi situatën krejt nën vëzhgim - në secilën shkollë, çdo ditë. Nëse ka një shpërthim lokal të virusit në shkollën tuaj, në koordinim me drejtuesit e shkollës suaj do të marrim menjëherë masat e nevojshme. Kjo mund të thotë që për shkollën e prekur mund të vendoset në mënyrë afatshkurtër që të mësohet prej shtëpie.

Shpresojmë, që përparimet në vaksinim të ndihmojnë që të mos vijmë deri në këtë pikë. Vaksinimi është dhe mbetet mbrojtja më efektive ndaj koronavirusit. Sa më shumë njerëz të mbrohen në të gjitha rajonet e Saksonisë, aq më e sigurt do të jetë edhe përditshmëria e zakonshme në shkollën tuaj.



Adresa e institucionit:
**Sächsisches Staatsministerium
für Kultus**
Carolaplatz 1
01097 Dresden

www.smk.sachsen.de

Lidhjet e transportit:
Arrihet me
linjat e tramvajit 3, 7, 8

Informacione rreth aksesit tek
dokumentet e nënshkruara
elektronikisht si dhe tek dokumentet
e koduara elektronikisht mund t'i
gjeni në faqen
www.smk.sachsen.de/kontakt.htm

Aktualisht, nuk mund të heqim dorë akoma nga rregullat AHA + L [distancë-higjienë-maskë + ajrosje] si dhe testet javore - në varësi të incidencës. Ashtu si në fushat të tjera publike, për ata që janë shëruar ose vaksinuar nuk është më i nevojshëm testimi kur hyni në shkollë .

Komisioni i Përhershëm i Vaksinimit tani rekomandon edhe për nxënësit e moshës 12 vjeç e sipër që të mbrohen nga koronavirusi SARS-CoV-2 me anë të vaksinimit. Vaksinimi natyrisht që është falas dhe vullnetar. Ai bëhet me vakcina mRNA të BioNTech/Pfizer dhe Moderna.

Veçanërisht fëmijëve dhe të rinjve u është dashur të mbajnë një barrë relativisht të rëndë muajve të fundit. Kjo është arsyeja pse ne duam t'ju bëjmë shpejt të mundur juve, nxënës të dashur, si dhe juve, prindër të dashur, që të vaksinoheni diku afër, sidomos aty ku qendrat e vaksinimit nuk gjenden afër për të gjithë.

Falë bashkëpunimit me Kryqin e Kuq Gjerman (DRK), tani mund të ofrojmë vaksinime nëpër shkollat e rretheve. Një skuadër mobile vaksinimi nga DRK shkon çdo ditë në secilin rreth. Oraret e vaksinimit janë planifikuar për orët e mëngjesit dhe të pasdites gjatë ditëve të javës në shkollat të zgjedhura kyçe. Nëse në shkollën tuaj lajmërohen më shumë se 80 persona që duan të vaksinohen, atëherë vaksinimi mund të vijë edhe direkt në shkollën tuaj. Lutemi të mirëkuptoni, se skuadrat e DRK-së vijnë sipas rendit kohor kur janë lajmëruar shkollat. Kolegët e DRK-së do të përdorin të gjithë kapacitetet e tyre për t'i bërë të mundur të gjitha vaksinimet.

Informacione të mëtejshme i gjeni tek udhëzimet e bashkëngjitura.

Lutemi të merrni kohën e nevojshme që të informoheni së bashku rreth argumenteve pro dhe kundër, për shembull me ndihmën e broshurës së koronës për fëmijë dhe të rinj nga Ministria e Çështjeve Sociale. Është vendimi juaj, nëse doni të shfrytëzoni mundësinë e vaksinimit në shkollë apo jo. Në Dresden, Chemnitz dhe Leipzig mund të shfrytëzohen mundësitë e qendrave të vaksinimit, si dhe të mjekëve pediatër dhe të përgjithshëm.

Që të planifikojmë në mënyrë optimale punën e skuadrave mobile të vaksinimit të DRK-së, kemi nevojë për ndihmën tuaj. Pyetësori, se sa njerëz dëshirojnë të vaksinohen nëpërmjet këtyre skuadrave mobile bëhet deri më datë 8 shtator 2021 përmes shkollës. Për këtë qëllim mund të përdoret për shembull formulari anonim i bashkëngjitur. Shkollat më pas, më datë 8 shtator 2021, ia raportojnë Zyrës Arsimore të Landit numrin e personave që dëshirojnë të vaksinohen. Regjistrimet e vonuara mund të bëhen deri më 15 shtator 2021.

Për ju, nxënës të dashur, dhe ju, prindër të dashur, pandemia ka sjellë kufizime dhe barra veçanërisht të rënda. Një përqindje e lartë e njerëzve të vaksinuar brenda dhe përreth shkollës suaj mund ta kthejë më në fund normalitetin në jetën shkollë dhe sigurisht edhe pak moskokëçarje më në fund. Ne falënderojmë të gjithë ata që na mbështesin në përpjekjet tona për të siguruar një mësim të sigurt në klasë - mundësisht pa kufizime - dhe që mbrojnë veten dhe të tjerët.

Me nderime,

Petra Köpping
Ministre e Shtetit Sakson për Çështjet Sociale
dhe Kohezionin Shoqëror

Christian Piwarz
Ministri i Shtetit Sakson
për Arsimin

Udhëzime rreth mundësisë për t'u vaksinuar nëpër shkolla

Nëse e pranoni apo jo mundësinë e vaksinimit, ky sigurisht që është një vendim individual. Duhet peshuar argumentet pro dhe kundër, nëse është e nevojshme edhe duke u këshilluar me mjekët. Edhe personi që është regjistruar njëherë për t'u vaksinuar, mund të tërhiqet kurdoherë mbrapsht.

Gjatë orarit të vaksinimit, nxënësit - ashtu si gjatë vizitave të nevojshme te mjeku - do të jenë të justifikuar nga ora e mësimi.

Në ditën e vaksinimit, lutemi t'u kushtoni vëmendje sa vijon:

- hani dhe pini mjaftueshëm,
- vishni rroba që ju lejojnë ta zhvishni lehtësisht pjesën e sipërme të krahut.

Ata që do të vaksinohen, ditën e vaksinimit duhet të sjellin me vete këto gjëra:

- librezën e vaksinimit (nëse e keni),
- një dokument identifikimi ose kartën e sigurimit shëndetësor,
- fletëinformacionin e plotësuar dhe të nënshkruar (shtojca 2),
- anamnezë e plotësuar me gjithë deklaratën e nënshkruar të miratimit (shtojca 3).

Në lidhje me SARS-CoV-2 do të merrni gjithashtu informacionin e mëposhtëm:

- Broshurën e koronës për fëmijë dhe adoleshentë (shtojca 4)

Për nxënësit që do të pranojnë të vaksinohen nga shkolla ose në shkollë, vlejné të njëjtat rregulla si në qendrat e vaksinimit për sa i përket dhënies së miratimit dhe shoqërimit:

- Për moshat 12 deri në 15 vjeç, përveç dhënies së miratimit prej të dy kujdestarëve ligjorë, kërkohet edhe që të paktën njëri nga kujdestarët ligjor të jetë i pranishëm gjatë vaksinimit.
- Për nxënësit e moshës 16 vjeç e sipër mjafton miratimi nga njëri prej kujdestarëve, dhe nuk është e detyrueshme prania e një kujdestari ligjor gjatë vaksinimit.
- Nxënësit dhe nxënëset e moshës madhore e nënshkruajnë vetë deklaratën e tyre të miratimit.

Gjatë vaksinimit në shkolla, personat shoqërues duhet të respektojnë rregullat e vlefshme për hyrjen në ambientet e shkollës në përputhje me nenin 3 të SchulKitaCoVO. Prindërit dhe personat e tjerë shoqërues kanë mundësi që të marrin falas vërtetimin e testit të nevojshëm, duke u testuar në shkollë.

Të gjithë ata që do të jenë të vaksinuar plotësisht, nuk janë të detyruar të testohen për të hyrë në ndërtesën e shkollës.

Në lidhje me sigurimin ligjor të mbrojtjes ndaj aksidenteve për nxënësit e shkollës vlen sa vijon:

- Gjatë rrugës dhe gjatë qëndrimit në vendin e vaksinimit nxënësit e shkollës kanë sigurim ligjor të mbrojtjes ndaj aksidenteve; kjo vlen si për vaksinimet nëpër shkolla ashtu edhe për vaksinimet në kuadrin e ekskursioneve për tek qendrat e vaksinimit të udhëhequra nga mësuesit.
- Për vetë vaksinimin nuk ka sigurim ligjor të mbrojtjes ndaj aksidenteve (dëme të mundshme nga vaksinimi mbulohet nga Ligji për Mbrojtjen ndaj Infeksionit).

Pjesëmarrje në vaksinimin ndaj koronës në shkollat e Landit Sachsen

Me anë të këtij formulari njoftues mund të deklarohet pa pasoja detyruese, nëse keni interes të vaksinoheni ndaj koronavirusit SARS-CoV-2 në shkollën tuaj ose në ndonjë shkollë afër.

Ky vlen si lajmërim edhe për prindërit ose pjesëtarët e familjes, të cilët dëshirojnë edhe ata të vaksinohen në shkollë në kuadër të vaksinimit ndaj koronavirusit.

Ky formular thjesht mund të dorëzohet tek mësuesi apo mësuesja kujdestare ose tek sekretaria e shkollës tënde/tuaj. Vetëm kaq.

Për planifikimin e vaksinimit, skuadrave mobile të vaksinimit iu nevojitet numri i nxënësve dhe nxënësve të interesuar. Pyetësi bëhet në mënyrë anonime: Lutemi mos jepni emër dhe mos e nënshkruani formularin. Dorëzoni gjithashtu për secilin fëmijë nga një formular.

Shkolla	
Klasa / Kursi	
Nxënësi / nxënësja merr pjesë në vaksinim	Shkruani po ose jo.
Të afërmit / personat shoqëruar që marrin pjesë në vaksinim	Jepni numrin.

FLETË INFORMUESE

Për vaksinimin kundër COVID-19 (**Corona Virus Disease 2019**)

– me vaksina me bazë mRNA – (Comirnaty® nga BioNTech/Pfizer dhe

COVID-19 Vaccine Moderna® nga Moderna)

AUFKLÄRUNGSMERKBLATT

Zur Schutzimpfung gegen COVID-19 (Corona Virus Disease 2019)

– mit mRNA-Impfstoffen –

(Comirnaty® von BioNTech/Pfizer und COVID-19 Vaccine Moderna® von Moderna)

Stadi: 11 qershor 2021 (kjo fletë informuese përditësohet vazhdimisht)

Stand: 11. Juni 2021 (dieser Aufklärungsbogen wird laufend aktualisiert)

Emri i personit që do të vaksinohet (ju lutemi me shkronja shtypi):

Name der zu impfenden Person (bitte in Druckbuchstaben):

Datëlindja:

Geburtsdatum:

Çfarë është COVID-19?

Koronaviruset njihen prej dekadash. Që nga ndërrimi i viteve 2019/2020, në mbarë botën po qarkullon një lloj i ri i koronavirusit, SARS-Coronavirus-2 (SARS-CoV-2), i cili është shkaktar i sëmundjes COVID-19 (Corona Virus Disease 2019).

Ndër simptomat e shpeshta të COVID-19 përfshihen kolla e thatë, temperatura, vështirësia në frymëmarrje, si dhe një humbje e përkohshme e shqisës së nuhatjes dhe të shijuarit. Gjithashtu raportohet edhe për një ndjesi të përgjithshme sëmundjeje me dhimbje koke dhe dhimbje gjymtyrësh, dhimbje fyti dhe rrufë. Në raste më të rralla, pacientët raportojnë ankesa gastrointestinale, konjunktivit dhe ënjtje të nyjave limfatike. Dëme në sistemin nervor ose kardiovaskular, si dhe ekziston mundësia për procese afatgjata të sëmundjes. Edhe pse kalimi i lehtë i sëmundjes është diçka e zakonshme dhe shumica e personave të sëmurur shërohen plotësisht, ekziston frika për zhvillime të rënda të saj, si për shembull me pneumoni, dhe kjo mund të çojë në vdekje.

Përveç shmangies së infeksionit duke respektuar rregullat AHA + A + L (mbaj distancën, zbato higjienën, mbaj maskë të përditshme, shkarko aplikacionin Corona-Warn, ajros rregullisht), vaksinimi ofron mbrojtjen më të mirë të mundshme kundër sëmundjeve.

Was ist COVID-19?

Coronaviren sind seit Jahrzehnten bekannt. Seit dem Jahreswechsel 2019/2020 zirkuliert weltweit ein neuartiges Coronavirus, das SARS-Coronavirus-2 (SARS-CoV-2), welches der Erreger der Krankheit COVID-19 (Corona Virus Disease 2019) ist.

Zu den häufigen Krankheitszeichen von COVID-19 zählen trockener Husten, Fieber, Atemnot sowie ein vorübergehender Verlust des Geruchs- und Geschmackssinnes. Auch ein allgemeines Krankheitsgefühl mit Kopf- und Gliederschmerzen, Halsschmerzen und Schnupfen wird beschrieben. Seltener berichten Patienten über Magen-Darm-Beschwerden, Bindehautentzündung und Lymphknotenschwellungen. Folgeschäden am Nerven- oder Herz-Kreislaufsystem sowie langanhaltende Krankheitsverläufe sind möglich. Obwohl ein milder Verlauf der Krankheit häufig ist und die meisten

Erkrankten vollständig genesen, kommen auch schwere Verläufe beispielsweise mit Lungenentzündung vor, die zum Tod führen können.

Neben dem Vermeiden einer Infektion durch Beachtung der AHA + A + L-Regeln (Abstand halten, Hygiene beachten, Alltag mit Maske, Corona-Warn-App herunterladen, regelmäßiges Lüften) bietet die Impfung den bestmöglichen Schutz vor einer Erkrankung.

Për cilën vaksinë bëhet fjalë?

Janë miratuar disa vaksina kundër COVID-19, të cilat janë njëlloj të përshtatshme për mbrojtje individuale kundër COVID-19 dhe për të luftuar pandeminë. Vaksinat mRNA COVID-19 që diskutohen këtu (Comirnaty® e BioNTech/Pfizer dhe vaksina COVID-19 Vaccine Moderna® e Moderna) janë vaksina gjenetike, të cilat bazohen tek e njëjta lloj teknologjie. Janë duke u testuar edhe vaksina të tjera me bazë mRNA, por nuk janë miratuar ende.

mRNA-ja (ARN-mesazhere ose acidi ribonukleik mesazher) është "manuali i ndërtimit" për secilën proteinë të trupit, e cila nuk duhet të ngatërrohet me informacionin gjenetik të njeriut – ADN-në. Vaksinat me bazë mRNA kundër COVID-19 janë një "manual ndërtimi" për një përbërës të vetëm të virusit (e ashtuquajtura proteina Spike/gjilpërë). Vaksinat mRNA kundër COVID-19 nuk përmbajnë kopje të virusit, që do të thotë se personat e vaksinuar nuk mund t'ua transmetojnë virusin personave të tjerë. mRNA që gjendet në vaksina nuk inkorporohet te gjëmoni i njeriut pasi bëhet vaksinimi, por ajo "lexohet" pasi futet në qeliza (kryesisht në qelizat e muskujve në vendin e vaksinimit dhe në disa qeliza të mbrojtjes), ku më pas këto qeliza prodhojnë vetë proteinat Spike/gjilpërë. Kështu proteinat Spike gjenerohen që prodhohen nga trupi i personit të vaksinuar njihen nga sistemi imunitar si proteina të huaja; si rezultat, prodhohen antitropa dhe qeliza imunitare kundër proteinës Spike të virusit. Kështu krijohet një përgjigje mbrojtëse imune.

mRNA që ndodhet në vaksinë degradohet në trup pas disa ditësh. Në këtë moment, proteina e virusit (proteina Spike) nuk prodhohet më.

Um welchen Impfstoff handelt es sich?

Es sind mehrere Impfstoffe gegen COVID-19 zugelassen, die geeignet sind, um sich individuell vor COVID-19 zu schützen und die Pandemie zu bekämpfen. Die hier besprochenen mRNA-COVID-19-Impfstoffe (Comirnaty® von BioNTech/Pfizer und COVID-19 Vaccine Moderna® von Moderna) sind genbasierte Impfstoffe, die auf der gleichen neuartigen Technologie beruhen. Weitere mRNA-Impfstoffe werden geprüft, sind aber derzeit noch nicht zugelassen.

mRNA (Boten-RNA oder messenger Ribonukleinsäure) ist die „Bauanleitung“ für jedes einzelne Eiweiß des Körpers und ist nicht mit der menschlichen Erbinformation - der DNA - zu verwechseln. In den mRNA-Impfstoffen gegen COVID-19 ist eine „Bauanleitung“ für einen einzigen Baustein des Virus (das sogenannte Spikeprotein) enthalten. Die COVID-19-mRNA-Impfstoffe enthalten keine vermehrungsfähigen Impfviren, d. h. geimpfte Personen können auch keine Impfviren auf andere Personen übertragen.

Die in den Impfstoffen enthaltene mRNA wird nach der Impfung nicht ins menschliche Erbgut eingebaut, sondern nach Eintritt in die Zellen (vor allem in Muskelzellen an der Impfstelle und in bestimmten Abwehrzellen) „abgelesen“, woraufhin diese Zellen dann das Spikeprotein selbst herstellen. Die so vom Körper des Geimpften gebildeten Spikeproteine werden vom Immunsystem als Fremdeiweiße erkannt; in der Folge werden Antikörper und Abwehrzellen gegen das Spikeprotein des Virus gebildet. So entsteht eine schützende Immunantwort.

Die im Impfstoff enthaltene mRNA wird im Körper nach einigen Tagen abgebaut. Dann wird auch kein Viruseiweiß (Spikeprotein) mehr hergestellt.

Si bëhet vaksina?

Vaksina injektohet në muskulin e pjesës së sipërme të krahut. Vaksina duhet të bëhet dy herë. Për të rriturit, Komiteti i Përhershëm për Imunizimin në Robert Koch Institute (STIKO) rekomandon një interval prej 6 javësh mes vaksinës së parë dhe vaksinës së dytë, me vaksinat COVID-19 mRNA. Për fëmijët dhe adoleshentët e moshës 12 deri në 17 vjeç, STIKO rekomandon një interval prej 3 deri në 6

javë midis të dyja vaksinave dhe Comirnaty®. Për momentin, vaksinimi i dytë duhet të jetë nga e njëjta vaksinë dhe nga i njëjti prodhues që është përdorur për vaksinimin e parë.

Këtu përjashtohen personat nën 60 vjeç, te të cilët është përdorur vakcina Vaxzevria® nga AstraZeneca për vaksinimin e parë. Për këta persona, aktualisht STIKO rekomandon që vaksinimi i dytë të bëhet me një vaksinë mRNA (Comirnaty® ose COVID-19 Vaccine Moderna®) 9 deri në 12 javë pas vaksinimit të parë. Arsyeja për këtë rekomandim është se në raste të rralla ndodhin mpiksje të gjakut (tromboza), ndonjëherë me pakësim të numrit të pllakëzave (trombocitopeni), kryesisht te personat nën 60 vjeç pas vaksinimit me Vaxzevria®. Rezultatet e studimeve fillestare tregojnë se kjo seri vaksinimesh (vaksinimi i parë me Vaxzevria® të pasuar me vaksinim të dytë me Comirnaty® ose vaksinë COVID-19 Vaccine Moderna®), janë pak a shumë të ngjashme me ato që paraqiten më poshtë për sa u përket efikasitetit dhe efekteve anësore.

Wie wird der Impfstoff verabreicht?

Der Impfstoff wird in den Oberarmmuskel gespritzt. Der Impfstoff muss zweimal verabreicht werden. Bei Erwachsenen empfiehlt die Ständige Impfkommission beim Robert Koch-Institut (STIKO) einen Abstand von 6 Wochen zwischen der 1. und der 2. Impfung mit den COVID-19-mRNA-Impfstoffen. Für Kinder und Jugendliche im Alter von 12 bis 17 Jahren empfiehlt die STIKO zwischen den beiden Impfungen mit Comirnaty® einen Abstand von 3 bis 6 Wochen. Bei der 2. Impfung muss gegenwärtig der gleiche Impfstoff desselben Herstellers verwendet werden wie bei der 1. Impfung.

Eine Ausnahme gilt bei Personen unter 60 Jahren, bei denen bei der 1. Impfung Vaxzevria® von AstraZeneca verwendet wurde. Für diese Personen empfiehlt die STIKO zurzeit, die 2. Impfung mit einem mRNA-Impfstoff (Comirnaty® oder COVID-19 Vaccine Moderna®) 9 bis 12 Wochen nach der 1. Impfung durchzuführen. Grund für diese Empfehlung ist das seltene Auftreten von Blutgerinnseln (Thrombosen) teilweise mit einer Verringerung der Blutplättchenzahl (Thrombozytopenie) vorwiegend bei Personen unter 60 Jahren nach der Impfung mit Vaxzevria®. Erste Studienergebnisse deuten darauf hin, dass diese Impfserie (1. Impfung mit Vaxzevria® gefolgt von 2. Impfung mit Comirnaty® oder COVID-19 Vaccine Moderna®), hinsichtlich Wirkungen und Nebenwirkungen mit den hier im Folgenden dargestellten vergleichbar ist.

Sa i efektshëm është vaksinimi?

Vaksinat e disponueshme për COVID-19 mRNA janë të ngjashme me njëra-tjetrën për sa i përket efikasitetit, si edhe reaksioneve dhe komplikacioneve të mundshme prej vaksinimit.

Sipas njohurive të deritanishme, vaksinat COVID-19 mRNA sigurojnë një përqindje të lartë efikasiteti prej rreth 95% në personat e moshës 16 vjeç e sipër (Comirnaty®) ose në personat e moshës 18 vjeç e sipër (COVID-19 Vaccine Moderna®). Të dhënat studimore deri tani tregojnë se rreziku për t'u infektuar me COVID-19 ishte rreth 95% më i ulët për ata që janë vaksinuar komplet për COVID-19 sesa ata që nuk janë vaksinuar. Efikasiteti në parandalimin e sëmundjes së rëndë prej COVID-19 (për shembull, shtrimi në spital), ishte rreth 85%. Kjo do të thotë se nëse një person që është vaksinuar me vaksinën për COVID-19 bie në kontakt me patogjenin, është shumë e lartë mundësia që të mos sëmuret. Ende nuk dihet se për sa kohë zgjat kjo mbrojtje prej vaksinës.

Vaksinimi i fëmijëve dhe adoleshentëve të moshave 12 deri në 15 vjeç me Comirnaty®:

Në një eksperiment klinik me 12 deri në 15-vjeçarë, vaksinimi me Comirnaty® shfaqti efikasitet prej rreth 100% për sa i përket sëmundjes COVID-19. Mund të supozohet që efikasiteti është po kaq i lartë në rastin e sëmundjes së rëndë me COVID-19.

Edhe nëse ju ose fëmija juaj e bëni vaksinën, përsëri është e nevojshme që të vazhdoni të zbatoni rregullat AHA + A+L, dhe prandaj duhet të mbroni veten tuaj dhe ambientin ku rri. Arsyeja është se mbrojtja nuk fillon menjëherë pas vaksinimit, dhe gjithashtu mbrojtja nuk është e njëjtë te të gjithë personat që vaksinohen. Përveç kësaj, ende nuk është e mundur të thuhet me siguri nëse personat që e kanë bërë vaksinën mund ta përhapin apo jo virusin (SARS-CoV-2).

Wie wirksam ist die Impfung?

Die verfügbaren COVID-19-mRNA-Impfstoffe sind hinsichtlich der Wirksamkeit und auch der möglichen Impfreaktionen und Komplikationen vergleichbar.

Nach derzeitigem Kenntnisstand bieten die COVID-19-mRNA-Impfstoffe bei Personen ab 16 Jahren (Comirnaty®) bzw. bei Personen ab 18 Jahren (COVID-19 Vaccine Moderna®) eine hohe Wirksamkeit von etwa 95 %. Die aktuellen Studiendaten zeigen: Die Wahrscheinlichkeit, an COVID-19 zu erkranken, war bei den vollständig gegen COVID-19 geimpften Personen um etwa 95 % geringer als bei den nicht geimpften Personen. Die Wirksamkeit in Bezug auf die Verhinderung einer schweren COVID-19-Erkrankung (also zum Beispiel einer Behandlung im Krankenhaus) war etwa 85 %. Das bedeutet: Wenn eine mit einem COVID-19-Impfstoff geimpfte Person mit dem Erreger in Kontakt kommt, wird sie mit hoher Wahrscheinlichkeit nicht erkranken. Wie lange dieser Impfschutz anhält, ist derzeit noch nicht bekannt.

Impfung von Kindern und Jugendlichen zwischen 12 und 15 Jahren mit Comirnaty®:

Eine vollständige Impfung mit Comirnaty® zeigte in einer klinischen Studie bei 12- bis 15-Jährigen eine Wirksamkeit gegenüber einer COVID-19-Erkrankung von etwa 100 %. Es ist davon auszugehen, dass die Wirksamkeit in Bezug auf eine schwere COVID-19-Erkrankung ähnlich hoch ist.

Auch wenn Sie bzw. Ihr Kind geimpft sind, ist es notwendig, dass Sie weiterhin die AHA + A + L-Regeln beachten und somit sich und Ihre Umgebung schützen. Gründe dafür sind, dass der Schutz nicht sofort nach der Impfung einsetzt und auch nicht bei allen geimpften Personen gleichermaßen vorhanden ist. Zudem lässt sich zurzeit noch nicht mit Sicherheit sagen, ob Personen das Virus (SARS-CoV-2) trotz Impfung weiterverbreiten können.

Kush duhet ta bëjë vaksinën kundër COVID-19?

Comirnaty® është aprovuar për personat e moshës 12 vjeç e sipër. COVID-19 Vaccine Moderna® është aprovuar për personat e moshës 18 vjeç e sipër.

STIKO rekomandon vaksinimin kundër COVID-19 për personat e moshës 18 vjeç e sipër. Të dyja vaksinat për COVID-19 me bazë mRNA që tregohen këtu, mund të përdoren për këtë grupmoshë.

Fëmijët dhe adoleshentët e moshës 12 deri në 17 vjeç: STIKO rekomandon vaksinimin me Comirnaty® në këtë grupmoshë për personat që janë të rrezikuar për sëmundje të rëndë ose vdekjeprurëse me COVID-19 për shkak të një sëmundjeje ekzistuese. Për personat në këtë grupmoshë që kanë kontakt me persona që janë veçanërisht të kërcënuar nga COVID-19, si edhe për adoleshentët që janë të rrezikuar të infektohen me SARS-CoV-2 për shkak të profesionit të tyre, STIKO po kështu rekomandon vaksinimin me Comirnaty®. Në përgjithësi, STIKO nuk rekomandon vaksinimin me Comirnaty® për fëmijët dhe adoleshentët e moshave 12 deri në 17 vjeç, të cilët nuk kanë sëmundje ekzistuese. Megjithatë, kjo është e mundur të bëhet pas konsultimit me mjekun dhe nëse personi që do të vaksinohet ose kujdestari i tij e kërkon vetë këtë dhe e pranon rrezikun. Përveç kësaj, STIKO thekson se për adoleshentët e moshës 16 deri në 17 vjeç, të cilët e kanë marrë tashmë dozën e parë të vaksinës, seria e vaksinimit duhet të përfundohet dhe se ata duhet ta marrin dozën e dytë të vaksinës.

Wer sollte gegen COVID-19 geimpft werden?

Comirnaty® ist für Personen ab 12 Jahren zugelassen.

COVID-19 Vaccine Moderna® ist für Personen ab 18 Jahren zugelassen.

Die STIKO empfiehlt die Impfung gegen COVID-19 für Personen ab 18 Jahren. Beide hier beschriebenen mRNA-COVID-19-Impfstoffe können für diese Altersgruppe verwendet werden.

Kinder und Jugendliche im Alter von 12 bis 17 Jahren: Die STIKO empfiehlt die Impfung mit Comirnaty® in dieser Altersgruppe für Personen, die aufgrund einer Vorerkrankung ein erhöhtes Risiko für einen schweren oder tödlichen Verlauf von COVID-19 aufweisen. Für Personen in dieser Altersgruppe, die engen Kontakt zu besonders durch COVID-19 gefährdeten Personen haben, sowie für Jugendliche, die arbeitsbedingt ein erhöhtes Risiko haben, sich mit SARS-CoV-2 anzustecken, empfiehlt die STIKO die Impfung mit Comirnaty® ebenfalls. Die Impfung mit Comirnaty® wird für Kinder und Jugendliche zwischen 12 und 17 Jahren ohne Vorerkrankungen derzeit von der STIKO nicht allgemein empfohlen, ist aber nach ärztlicher Aufklärung und bei individuellem Wunsch und Risikoakzeptanz der zu impfenden Person bzw. deren Sorgeberechtigten möglich. Die STIKO weist zudem daraufhin, dass bei Jugendlichen im Alter von 16 bis 17 Jahren, die bereits eine 1. Impfung erhalten haben, die Impfserie vervollständigt werden soll und sie eine 2. Impfung erhalten sollen.

Kush nuk duhet vaksinuar?

Fëmijët deri në moshën 11 vjeç, duke përfshirë moshën 15 vjeç, për të cilët aktualisht nuk është aprovuar asnjë vaksinë, nuk duhet të vaksinohen.

Kushdo që vuan nga një sëmundje akute me temperaturë mbi 38,5°C duhet të vaksinohet vetëm pasi të shërohet. Sidoqoftë, një ftohje ose një temperaturë paksa e ngritur (nën 38,5°C) nuk është arsye për ta shtyrë vaksinimin. Nëse keni ndjeshmëri të lartë ndaj një përbërësi vaksine, nuk duhet të vaksinoheni: ju lutemi informoni mjekun/mjekën e vaksinimit para vaksinimit nëse keni alergji. Çdo person që ka pasur reaksion të menjëhershëm alergjik (anafilaksis) pas vaksinës së parë, nuk duhet ta bëjë vaksinën e dytë.

Personat pa imunodeficienca, për të cilët është vërtetuar në mënyrë të besueshme infeksioni me koronavirusin e ri, si rregull mund të vaksinohen më herët se 6 muaj pas shërimit ose pas diagnostikimit, dhe duhet të bëjnë vetëm një dozë të vaksinës. Edhe në rastet kur kanë kaluar më shumë se 6 muaj që prej diagnostikimit, një dozë e vaksinës është e mjaftueshme. Për momentin, nuk është e mundur të thuhet nëse vaksinimi i dytë do të ishte apo jo i nevojshëm në këta persona në një datë të mëvonshme dhe kur do të ishte i nevojshëm. Për personat për të cilët është vërtetuar në mënyrë të besueshme infeksioni me koronavirusin e ri pas vaksinimit të parë, STIKO rekomandon që, si rregull, vaksinimi i dytë të bëhet 6 muaj pas shërbimit ose diagnostikimit. Nuk ekzistojnë prova se vaksinimi përbën rrezik nëse dikush ka pasur infeksion në të kaluarën. Prandaj, nga ana mjekësore nuk është e nevojshme që kjo të përjashtohet para vaksinimit.

Nuk ka ende eksperiencë të mjaftueshme në lidhje me përdorimin e vaksinave COVID-19 mRNA gjatë shtatzënisë. Aktualisht STIKO nuk rekomandon vaksinimin e përgjithshëm gjatë shtatzënisë - pavarësisht llojit të vaksinës kundër COVID-19. Megjithatë, në raste të veçanta, grave shtatzëna mund t'u ofrohet vaksinimi duke filluar nga tremujori i 2-të i shtatzënisë me një vaksinë mRNA (Comirnaty® ose COVID-19 Vaccine Moderna®) pasi të bëhet një vlerësim i riskut dhe të merren informacione të hollësishme. Gjatë vlerësimit të riskut duhet të merren parasysh problemet shëndetësore ekzistuese të cilat janë në rrezik të lartë për sëmundje të rëndë me COVID-19 ose rrethanat personale që paraqesin rrezik të lartë për t'u sëmurur me SARS-CoV-2. STIKO mendon se është thujtë e pamundur që vaksinimi i nënës gjatë shtatzënisë të përbëjë rrezik për foshnjën.

Wer soll nicht geimpft werden?

Kinder bis einschließlich 11 Jahre, für die aktuell kein Impfstoff zugelassen ist, sollen nicht geimpft werden.

